

Mortality Works!

By Elder Brook P. Hales
Of the Seventy

Vdekshmëria e Kryen Funksionin!

Nga Plaku Bruk P. Hejls,
i Të Shtatëdhjetëve

October 2024 general conference

Despite the challenges we all face, our loving Heavenly Father has designed the plan of happiness such that we are not destined to fail.

For several years I was assigned to home teach an older sister in my ward. She did not have an easy life. She had various health problems and experienced a lifetime of pain due to a childhood accident on the playground. Divorced at age 32 with four young children to raise and provide for, she remarried at age 50. Her second husband passed away when she was 66, and this sister lived an additional 26 years as a widow.

Despite her lifelong challenges, she was faithful to her covenants to the end. This sister was an avid genealogist, a temple attender, and a collector and writer of family histories. Though she had many difficult trials, and without question she felt at times sadness and loneliness, she had a cheerful countenance and a gracious and pleasant personality.

Nine months after her passing, one of her sons had a remarkable experience in the temple. He learned by the power of the Holy Ghost that his mother had a message for him. She communicated with him, but not by vision or audible words. The following unmistakable message came into the son's mind from his mother: "I want you to know that mortality works, and I want you to know that I now understand why everything happened [in my life] the way it did—and it is all OK."

This message is all the more remarkable

Pavarësisht nga sfidat me të cilat përballemi të gjithë, Ati ynë i dashur Qiellor e ka hartuar planin e lumturisë në mënyrë të tillë që e kemi të paracaktuar të mos dështojmë.

Për disa vjet u caktova të bëja mësimet e shtëpisë të një motër e moshuar e lagjes. Ajo nuk kishte një jetë të lehtë. Kishte probleme të ndryshme shëndetësore dhe përjetoi gjithë jetën dhembje për shkak të një aksidenti në këndin e lojërave në fëmijëri. E shkurorëzuar në moshën 32-vjeçare me katër fëmijë të vegjël për të rritur dhe ushqyer, u rimartua në moshën 50-vjeçare. Bashkëshorti i dytë i vdiq kur ajo ishte 66 vjeçe; dhe kjo motër jetoi edhe 26 vjet të tjera si vëjushë.

Pavarësisht një jete të tërë me sfida, që besnike deri në fund ndaj besëlidhjeve të veta. Kjo motër ishte një gjenealogjiste e zjarrtë, frekuentuese e tempullit, koleksioniste dhe shkruese e historive familjare. Ndonëse kishte shumë sprova të vështira, dhe pa diskutim që ndonjëherë ndiente trishtim dhe vetmi, kishte një pamje të gëzuar dhe një personalitet të hijshëm e të këndshëm.

Nëntë muaj pasi ndërroi jetë, njëri nga djemtë e saj pati një përvojë mbresëlënëse në tempull. Nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, ai mësoi se e ëma kishte një mesazh për të. Ajo komunikoi me të, por jo me anë të vegimit apo fjalëve të dëgjueshme. Mesazhi i pagabueshëm që pason i erdhi në mendje djalit nga nëna: "Dua që të dish se vdekshmëria e kryen funksionin e saj dhe dua që të dish se tani e kuptoj se pse të gjitha gjërat [në jetën time] ndodhën ashtu si ndodhën – dhe gjithçka është në rregull".

Ky mesazh është akoma më mbresëlënëse

when one considers her situation and the difficulties this sister endured and overcame.

Brothers and sisters, mortality works! It is designed to work! Despite the challenges, heartaches, and difficulties we all face, our loving, wise, and perfect Heavenly Father has designed the plan of happiness such that we are not destined to fail. His plan provides a way for us to rise above our mortal failures. The Lord has said, “This is my work and my glory—to bring to pass the immortality and eternal life of man.”

Nonetheless, if we are to be the beneficiaries of the Lord’s “work and ... glory,” even “immortality and eternal life,” we must expect to be schooled and taught and to pass through the refiner’s fire—sometimes to our utter limits. To completely avoid the problems, challenges, and difficulties of this world would be to sidestep the process that is truly necessary for mortality to work.

And so we should not be surprised when hard times come upon us. We will encounter situations that try us and people who enable us to practice true charity and patience. But we need to bear up under our difficulties and remember, as the Lord said:

“And whoso layeth down his life in my cause, for my name’s sake, shall find it again, even life eternal.

“Therefore, be not afraid of your enemies [or your problems, challenges, or the tests of this life], for I have decreed ... , saith the Lord, that I will prove you in all things, whether you will abide in my covenant ... that you may be found worthy.”

When we feel distraught or anxious about our problems or feel that we might be receiving more than our fair share of life’s difficulties, we can remember what the Lord said to the children of Israel:

“And thou shalt remember all the way[s] which the Lord thy God led thee these forty years in the wilderness, to humble thee, and to prove thee, to know what [is] in thine heart, whether thou [would] keep his commandments, or no.”

As Lehi taught his son Jacob:

“Thou hast suffered afflictions and much sorrow. ... Nevertheless, ... [God] shall consecrate thine afflictions for thy gain. ... Wherefore,

kur dikush merr parasysh situatën e saj dhe vështirësitë që duroi dhe kapërceu kjo motër.

Vëllezër dhe motra, vdekshmëria e kryen funksionin e saj! Është hartuar që të funksionojë! Pavarësisht nga sfidat, pikëllimet dhe vështirësitë me të cilat përballemi të gjithë, Ati ynë i dashur, i urtë dhe i përsosur Qiellor e ka hartuar planin e lumturisë në mënyrë të tillë që e kemi të paracaktuar të mos dështojmë. Plani i Tij siguron një mënyrë që të ngrihemi mbi dështimet tona në vdekshmëri. Zoti ka thënë: “Kjo është vepra ime dhe lavdia ime – të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”.

Megjithatë, nëse duam të jemi përfitues të “vepr[ës] dhe lavdi[së]” së Zotit, madje edhe të “pavdekësi[së] dhe jet[ës] [së] përjetshme”, duhet të presim që të shkollohemi e të marrim mësim, dhe të kalojmë përmes zjarrit të rafinuesit, herë-herë deri në caqet tona më të tejme. Shmangia e plotë e problemeve, sfidave dhe vështirësive të kësaj bote do të ishte anashkalim i procesit që është njëmend i nevojshëm që vdekshmëria të funksionojë.

Ndaj nuk duhet të befsohemi kur të na vijjnë kohë të vështira. Do të hasim situata që na sprovojnë dhe njerëz që na mundësojnë të ushtrojmë dashuri hyjnore dhe durim të vërtetë. Por duhet t’u bëjmë ballë trimërisht vështirësive tona dhe të kujtojmë, siç tha Zoti:

“Dhe kushdo që e jep jetën e tij për kauzën time, për hir të emrit tim, do ta gjejë atë përsëri, madje jetë të përjetshme.

Si rrjedhim, mos kini frikë nga armiqtë tuaj [ose problemet, sfidat tuaja apo provat e kësaj jete], sepse unë kam dekretuar ..., thotë Zoti, që unë do t’ju vë në provë në gjithçka, nëse do ta duroni besëlidhjen time ... që ju të mund të gjendeni të denjë.”

Kur ndihemi të brengosur ose në ankth për problemet tona ose mendojmë se mund të na ketë rënë një hise më e madhe vështirësish në jetë se ajo që na takon, mund të kujtojmë atë që Zoti u tha bijve të Izraelit:

“Kujto gjithë rrugë[t] që Zoti, Perëndia yt, të ka bërë të përshkosh në kët[a] dyzetë vjet në shkretëtirë që ti të ulësh kokën dhe të viresh në provë, për të ditur çfarë [ke] në zemrën tënde dhe në se do [t’i] respektoje apo jo urdhërimet e tij”.

Sikurse Lehi e mësoi birin e tij, Jakobin:

“Ti ke vuajtur hidhërime dhe shumë brenga. ... Megjithatë, ... [Perëndia] do t’i shenjtërojë hidhërimet e tua për të mirë. ... Prandaj, unë

I know that thou art redeemed, because of the righteousness of thy Redeemer.”

Because this life is a testing ground and “dark clouds of trouble hang o’er us and threaten our peace to destroy,” it is helpful to remember this counsel and promise found in Mosiah 23 relating to life’s challenges: “Nevertheless—whosoever putteth his trust in [the Lord] the same shall be lifted up at the last day.”

As a youth, I personally experienced great emotional pain and shame that came as the result of the unrighteous actions of another, which for many years affected my self-worth and my sense of worthiness before the Lord. Nevertheless, I bear personal witness that the Lord can strengthen us and bear us up in whatever difficulties we are called upon to experience during our sojourn in this vale of tears.

We are familiar with Paul’s experience:

“And lest I should be exalted above measure through the abundance of the revelations [I have received], there was given to me a thorn in the flesh, the messenger of Satan to buffet me, lest I should be exalted above measure.

“For this thing I besought the Lord thrice, that it might depart from me.

“And he said unto me, My grace is sufficient for thee: for my strength is made perfect in weakness. Most gladly therefore will I rather glory in my infirmities, that the power of Christ may rest upon me.”

We don’t know what Paul’s “thorn in the flesh” was. He chose not to describe whether it was a physical ailment, a mental or emotional infirmity, or a temptation. But we don’t need to know that detail to know that he struggled and pleaded with the Lord for help and that, ultimately, the Lord’s strength and power are what helped him through it.

Like it was for Paul, it was through the Lord’s help that I was eventually strengthened emotionally and spiritually and finally recognized after many years that I have always been a person of worth and worthy of the blessings of the gospel. The Savior helped me to overcome my feelings of unworthiness and to extend sincere forgiveness to the offender. I finally understood that the Savior’s Atonement was a personal gift for me and that my Heavenly Father and His Son love me perfectly. Because of the Savior’s Atonement, mortality works.

e di që ti je shëlbuar, për shkak të drejtësisë së Shëlbuesit tënd.”

Për shkak se kjo jetë është një terren prove dhe “re t’zeza hallesh mbi ne jan’ [dhe] paqen na kërc’nojn’ me shkat’rrim”, është e dobishme të kujtojmë këtë këshillë dhe premtim që gjendet te Mosia 23 lidhur me sfidat e jetës: “Megjithatë – kushdo që vendos besimin e tij [te Zoti], po ai do të ngrihet në ditën e fundit”.

Kur isha i ri, personalisht përjetova dhembje dhe turp të madh emocional që erdhi si pasojë e veprimeve të padrejta të dikujt tjetër, të cilat për shumë vjet ndikuan në vlerën që i jepja vetes dhe në ndjesinë e denjësisë sime para Zotit. Sidoqoftë, jap dëshmi vetjake se Zoti mund të na forcojë dhe të na japë zemër në çfarëdo vështirësie që jemi thirrur të përjetojmë gjatë qëndrimit tonë në këtë luginë lotësh.

Ne e njohim përvojën e Palit:

“Dhe, që të mos më rritet mendja për shkak të jashtëzakonshmërisë së zbulesave [që kam marrë], m’u dha një gj[e]mb në mish, një engjell i Satanit, për të më rënë me grushta, që të mos mbahem me të madh.

Lidhur me këtë iu luta tri herë Zotit që ta largonte nga unë.

Por ai më tha: ‘Hiri im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi’. Prandaj me kënaqësi të madhe do të krenohem më tepër për dobësitë e mia, që fuqia e Krishtit të rrijë tek unë.”

Ne nuk e dimë se çfarë ishte “gj[e]mb[i] në mish” i Palit. Ai zgjodhi të mos e përshkruante a ishte një sëmundje fizike, një lëngatë mendore ose emocionale, apo një tundim. Nuk na duhet ta dimë atë hollësi për të ditur se ai po mundohej dhe iu përgjërua Zotit për ndihmë dhe se përfundimisht, forca dhe fuqia e Zotit janë ato që e ndihmuan ta kalonte.

Ashtu si me Palin, me anë të ndihmës së Zotit, përfundimisht edhe unë u forcova emocionalisht dhe shpirtërisht dhe më në fund e kuptova pas shumë vjetësh se kam qenë gjithmonë një person me vlerë dhe i denjë për bekimet e engjillit. Shpëtimtari më ndihmoi t’i kapërceja ndjenjat e padenjësisë dhe t’i jepja falje të sinqertë keqtrajtuesit. Më në fund e kuptova se Shlyerja e Shpëtimtarit ishte një dhuratë posaçërisht për mua dhe se Ati im Qiellor dhe Biri i Tij më duan në mënyrë të përsosur. Për shkak të Shlyerjes së Shpëtimtarit, vdekshmëria e kryen funksionin e saj.

While I was eventually blessed to recognize how the Savior rescued me and stood by me through those experiences, I clearly understand that the unfortunate situation of my teenage years was my personal journey and experience, the resolution of which and eventual outcome cannot be projected onto those who have suffered and continue to suffer from the unrighteous behavior of others.

I recognize that life's experiences—good and bad—can teach us important lessons. I now know and bear testimony that mortality works! I hope that as a result of the sum of my life's experiences—good and bad—I have compassion for innocent victims of another's actions and empathy for the downtrodden.

I sincerely hope that as a result of my life's experiences—good and bad—I am kinder to others, treat others as the Savior would, and have greater understanding for the sinner and that I have complete integrity. As we come to rely on the Savior's grace and keep our covenants, we can serve as examples of the far-reaching effects of the Savior's Atonement.

I share a final example that mortality works.

Elder Hales's aunt, Lois VandenBosch, and his mother, Klea VandenBosch.

My mother did not have an easy journey through mortality. She received no accolades or worldly honors and did not have educational opportunities beyond high school. She contracted polio as a child, resulting in a lifetime of pain and discomfort in her left leg. As an adult, she experienced many difficult and challenging physical and financial circumstances but was faithful to her covenants and loved the Lord.

When my mother was 55, my next older sister passed away, leaving an eight-month-old baby daughter, my niece, motherless. For various reasons, Mom ended up largely raising my niece for the next 17 years, often under very trying circumstances. Yet, notwithstanding these experiences, she happily and willingly served her family, neighbors, and ward members and served as an ordinance worker in the temple for many years. During the last several years of her life, Mom suffered from a form of dementia, was often confused, and was confined to a nursing fa-

Ndërsa përfundimisht u bekova për të kuptuar se si Shpëtimtari më shpëtoi dhe më qëndroi përkrah përgjatë atyre përvojave, e kuptoj qartë se situata fatkeqe e viteve të mia të adoleshencës ishte rrugëtimi dhe përvoja ime personale, për zgjidhjen dhe pasojën përfundimtare të së cilës nuk mund t'u vihet gishti atyre që kanë vuajtur dhe vazhdojnë të vuajnë nga sjellja e padrejtë e të tjerëve.

E kuptoj që përvojat e jetës, të mira dhe të këqija, mund të na japin mësim të rëndësishme. Tani e di dhe jap dëshmi se vdekshmëria e kryen funksionin e saj! Shpresoj që si rezultat i mbledhjes së përvojave të jetës sime, të mira dhe të këqija, të kem dhembshuri për viktimat e pafajshme të veprimeve të dikujt tjetër dhe ndjeshmëri për të shtypurit!

Shpresoj sinqerisht që si rezultat i përvojave të jetës sime, të mira dhe të këqija, të jem më i sjellshëm me të tjerët, t'i trajtoj të tjerët siç do të bënte Shpëtimtari, të kem mirëkuptim më të madh për mëkatarin dhe të kem integritet të plotë moral. Ndërsa arrijmë të mbështetemi te hiri i Shpëtimtarit dhe i mbajmë besëlidhjet tona, mund të shërbejmë si shembuj të rrjedhëve largpamëse të Shlyerjes së Shpëtimtarit.

Po jap një shembull të fundit që vdekshmëria e kryen funksionin e saj.

Tezja e Plakut Hejls, Llois VandenBosh dhe nëna e tij, Klea VandenBosh.

Nëna ime nuk pati një rrugëtim të lehtë përgjatë vdekshmërisë. Ajo nuk mori vlerësime apo nderime nga bota, dhe nuk pati mundësi arsimimi përtej shkollës së mesme. E zuri polio-mieliti kur ishte fëmijë, gjë që i shkaktoi një jetë të tërë me dhembje dhe bezdi në këmbën e majtë. Në moshë madhore, përjetoi shumë rrethana të vështira e sfiduese fizike dhe financiare, por që besnike ndaj besëlidhjeve të saj dhe e donte Zotin.

Kur nëna ime ishte 55 vjeçe, motra ime që qe pak më e madhe se unë ndërroi jetë, duke lënë pa nënë një vajzë tetëmuajshe, mbesën time. Për arsye të ndryshme, nëna ime përfundoi duke u kujdesur shumicën e kohës për mbesën time për 17 vitet pasuese, shpesh në rrethana tejet të vështira. Prapëseprapë, pavarësisht nga këto përvoja, ajo i shërbeu me gëzim dhe gatishmëri familjes, fqinjëve dhe anëtarëve të lagjes, dhe shërbeu si punonjëse ordinancash në tempull për shumë vjet. Gjatë disa viteve të fundit të jetës, nëna vuajti nga një formë demence, ngatërrohej

cility. Regrettably, she was alone when she passed away unexpectedly.

Several months after her passing, I had a dream I have never forgotten. In my dream, I was sitting in my office at the Church Administration Building. Mom entered the office. I knew she had come from the spirit world. I will always remember the feelings I had. She did not say anything, but she radiated a spiritual beauty that I had never before experienced and which I have difficulty describing.

Her countenance and being were truly stunning! I remember saying to her, “Mother, you are so beautiful!” referencing her spiritual power and beauty. She acknowledged me—again without speaking. I felt her love for me, and I knew then that she is happy and healed from her worldly cares and challenges and eagerly awaits “a glorious resurrection.” I know that for Mom, mortality worked—and that it works for us too.

God’s work and glory is to bring to pass the immortality and eternal life of man. The experiences of mortality are part of the journey that allows us to grow and progress toward that immortality and eternal life. We were not sent here to fail but to succeed in God’s plan for us.

As King Benjamin taught: “And moreover, I would desire that ye should consider on the blessed and happy state of those that keep the commandments of God. For behold, they are blessed in all things, both temporal and spiritual; and if they hold out faithful to the end they are received into heaven, that thereby they may dwell with God in a state of never-ending happiness.” In other words, mortality works!

I testify that as we receive the ordinances of the gospel, enter into covenants with God and then keep those covenants, repent, serve others, and endure to the end, we too can have the assurance and complete trust in the Lord that mortality works! I testify of Jesus Christ and that our glorious future with our Heavenly Father is made possible by the grace and Atonement of the Savior. In the name of Jesus Christ, amen.

shpesh dhe jetoi e mbyllur në një godinë përkuja-desjeje. Me keqardhje, ajo që vetëm kur u largua nga jeta papritur.

Disa muaj pasi vdiq, pashë një ëndërr që nuk e kam harruar kurrë. Në ëndërr, isha ulur në zyrën time në Ndërtesën e Administrimit të Kishës. Nëna hyri në zyrë. E dija që kishte ardhur nga bota e shpirtave. Do t’i kujtoj përherë ndjenjat që pata. Nuk tha asnjë fjalë, por rrezatonte një bukuri shpirtërore që nuk e kisha përjetuar kurrë më parë dhe që e kam të vështirë ta përshkruaj.

Pamja dhe qenia e saj ishin vërtet mahnitëse! Mbaj mend që i thashë: “Nënë, sa e bukur je!”, – duke iu referuar fuqisë dhe bukurisë së saj shpirtërore. Ajo më njohu, sërish pa folur. E ndjeva dashurinë e saj për mua dhe e kuptova atëherë se ajo është e lumtur dhe e shëruar nga shqetësimet dhe sfidat e botës dhe pret me ëndje “një ringjallje të lavdishme”. E di se për nënën vdekshmëria e kreu funksionin e saj, dhe ajo e kryen funksionin e vet edhe për ne.

Vepra dhe lavdia e Perëndisë është të bëjë të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut. Përvojat e vdekshmërisë janë pjesë e rrugëtimit që na lejojnë të rritemi dhe të përparojmë drejt asaj pavdekësie dhe jete të përjetshme. Nuk u dërguam këtu për të dështuar, por për t’ia dalë mbanë në planin e Perëndisë për ne.

Siç dha mësim Mbreti Beniamin: “Dhe për më tepër, unë do të doja që ju të keni parasysh gjendjen e bekuar dhe të lumtur të atyre që zbatojnë urdhërimet e Perëndisë. Pasi vini re, ata janë të bekuar në të gjitha gjërat, qoftë tokësore ashtu edhe shpirtërore; dhe nëse qëndrojnë besnikë deri në fund, ata janë marrë në qiell, që si rrjedhim të jetojnë me Perëndinë, në një gjendje lumturie të pafund.” Me fjalë të tjera, vdekshmëria e kryen funksionin e saj!

Dëshmoj se kur marrim ordinancat e ungjillit, hyjmë në besëlidhje me Perëndinë dhe më pas i mbajmë ato besëlidhje, pendohemi, u shërbejmë të tjerëve dhe durojmë deri në fund, edhe ne mund të kemi sigurinë dhe mirëbesimin e plotë të Zotit se vdekshmëria e kryen funksionin e saj! Dëshmoj për Jezun Krishtin dhe se e ardhmja e lavdishme me Atin tonë Qiellor është bërë e mundur nëpërmjet hirit dhe Shlyerjes së Shpëtimtarit. Në emrin e Jezut Krishtit, amen.